



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-283/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Mezonir 340 WG i prodhuesit “Innvigo Sp. z o.o.”, Poloni nga përfaqësuesi i saj “ Monuni”, SH.P.K, Gjilan.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Mezotrione.....240g/kg
Nicosulfuron.....80g/kg
Rimsulfuron.....20g/kg

4. PËRDORIMI:

Mezonir 340 WG absorbohet kryesisht përmes gjetheve dhe përveç kësaj edhe përmes rrënjëve dhe lëviz shpejt brenda bimës, duke penguar rritjen dhe zhvillimin e saj. Efektet e para janë të dukshme menjëherë pas aplikimit, pas së cilës bimët gradualisht do të humbin ngjyën. Barërat e këqija do të shkatërrohen plotësisht 10-25 ditë pas trajtimit. Përdoreni produktin kur barërat e këqija janë në fazën me 1 deri 8 gjethe të shpalosura. Produkti është më efektiv në barërat e këqija njëvjeçare në fazën me

2-3 gjehe të shpalosura (barërat e këqija dykotiledone) ose në fazën me 305 gjethe të shpalosura (barërat e këqija monokotiledone). Elimi/pirovina (*Elymus repens*) duket të ketë 5-7 gjethe (15-25 cm) në kohën e trajtimit. Në rast të rrëzikut të shfaqjes së barërave të këqija që kanë kërkesa për nxehtësi, p.sh., idhankthi i zi, muhari, nena e përveshur, produkti duhet të aplikohet pas paraqitjes së tyre.

A) Produkti aplikohet individualisht në dozë prej 0,5 kg/ha

Barërat e këqija të ndjeshme:	<i>Solanum nigrum</i> (idhnaku i zi), <i>Raphanus raphanistrum</i> (rrepani i egër), <i>Brassica napus</i> (sinapi i vetëmbirë), <i>Amaranthus retroflexus</i> (nena e përveshur), <i>Galinsoga parviflora</i> (galinsog lulevogël).
Barërat e këqija me ndjeshmëri mesatare:	<i>Echinochloa crus-galli</i> (muhari), <i>Viola arvensis</i> (manushaqja e fushave), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbuta e purpurt), <i>Chenopodium album</i> (minueri i bardhë), <i>Galium aparine</i> (ngjitësja rrodhe), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomili), <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtrapëra) dhe <i>Thlaspi arvense</i> (tlaspi i arave).

B) Produkti aplikohet në dozë prej 0,5 kg/ha në përzjerje me lagështuesin Asystem + në dozë prej 100ml/ha.

Barërat e këqija të ndjeshme:	<i>Echinochloa crus-galli</i> (muhari), <i>Chenopodium album</i> (minueri i bardhë), <i>Solanum nigrum</i> (idhnakthu i zi), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomili), <i>Raphanus raphanistrum</i> (rrepani i egër), <i>Brassica napus</i> (sinapi i vetëmbirë), <i>Amaranthus retroflexus</i> (nena e përveshur), <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtrapëra), <i>Thlaspi arvense</i> (tlaspi i arave) dhe <i>Galinsoga parviflora</i> (galinsogu lulevogël).
Barërat e këqija mesatarisht të ndjeshme:	<i>Viola arvensis</i> (manushaqja e fushave), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbuta e purpurt), <i>Galium aparine</i> (ngjithësja rrodhe).

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

500g, 1000g, 1500g, 5000g.

6. VËREJTJE:

Mos i ndotni ujërat me produktin e mbrojtjes së bimëve ose ambalazhin e tij. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes kullmëve nga fermat dhe rrugët. Shmangni çdo derdhje në mjedis, përveç qëllimit të përdorimit. Për të mbrojtur organizmat ujorë, është e nevojshme të krijoni një zonë mbrojtjeje të mbuluar me bar me një gjetësi prej 20m nga rezervuarët e ujit dhe rrjedhat e ujit. Për të mbrojtur bimët dhe artropodët jo të synuar, respektoni një zonë mbrojtjeje të pa spërkatur: 20m nga toka jo-bujqësore ose 10m nga tokat jo-bujqësore me përdorimin e njëkohshëm të masave që reduktojnë shpërndarjen e tretësirës për spërkatje gjatë trajtimit me 50 % ose 5m nga toka jo-bujqësore me përdorimin e njëkohshëm të masave që reduktojnë shpërndarjen e tretësirës për spërkatje gjatë trajtimit me 75%.

7. KARENCA:

Nuk ka.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*